



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:073996

Datë: 06.06.2024

Numri i dokumentit: 05792692

KPPP.nr.2604/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbarimore të kreditorit “King Holding” SH.P.K., me seli në rr. “Sadik Stavileci”, në Gjakovë, kundër debitorit “Vali” SH.P.K., me seli në Komoran, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.649/17 të datës 28.12.2017 të Përmbaruesit Privat Gjokë Radi, me seli në Gjakovë, jashtë seancës me datën 06.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit “Vali” SH.P.K., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.649/17 të datës 28.12.2017, të Përmbaruesit Privat Gjokë Radi.
- II. MBETET në fuqi Urdhri Përmbarimor P.nr.649/17 i datës 28.12.2017 i lejuar nga Përmbaruesi Privat Gjokë Radi.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Medruplast N.T.P.” B.I., ka lëshuar urdhrin përmbarimor P.nr.649/17 të datës 28.12.2017, me të cilin ka lejuar përmbarimin, në bazë të dokumentit të besueshëm: Faturës Nr. 06/2017 të datës 06.09.2017; Faturës Nr. 09/2017 të datës 10.11.2017; Faturës Nr. 10/2017 të datës 13.11.2017 dhe Faturës Nr. 13/2017 të datës 14.12.2017, me të cilën është detyruar debitori që brenda afatit prej 7 ditësh t’ia paguaj kreditorit borxhin në shumën prej 24,445.89 €, me kamatë ligjore, si dhe të gjitha shpenzimet përmbarimore, që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të propozimit, ashtuqë

të gjitha detyrimet duhet të realizohen përmes bllokimit të llogarive bankare të debitorit dhe bartjen e tyre në llogarinë bankare të veçantë të përmbauesit privat, ndërsa nëse debitori nuk posedon mjete monetare në llogaritë bankare, përmbauesi privat të zbatoj përmbauesin përmes sekuestrimit të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit dhe me shitjen e tyre të bëhet inkasimi i borxhit në llogari të kreditorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar urdhrin përmbauesor duke theksuar ndër të tjera se faturat e bashkëngjitura nga kreditori në propozim janë të ndryshme nga faturat të cilat debitori i ka pranuar. Më tutje ka theksuar se faturat të cilat janë pranuar nga debitori janë paraqitur si shpenzime pranë ATK. Ka deklaruar se me datën 29.12.2017 është bërë pagesa në tërësi e vlerës së përgjithshme prej 24,000.00 €, ku është realizuar edhe pagesa e fundit në shumën prej 6,000.00 € me para në dorë, ndërsa për shumën në vlerën prej 445.89 € nuk është në dijeni se nga ka ardhur ky obligim. Gjykatës i ka propozuar që të refuzohet si i pabazuar urdhri për përmbauesor.

Kreditori në përgjigjen në prapësim, i ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, ku ndër të tjerash ka deklaruar se faturat e lartcekura janë pranuar nga debitori konform marrëveshjes me shkrim të lidhur me datë 17.12.2017 mes palëve ndërgjyqëse, ku pas përfundimit të punimeve kanë bërë marrëveshjen e pranimit të punimeve, si dhe barazimin përfundimtar për të gjitha punët e realizuara dhe kanë nxjerrë shumën totale të borxhit, për të cilën pala debitore e ka nënshkruar të njëjtën. Në lidhje me pretendimet e debitorit rreth realizimit të pagesës së këtyre faturave, ka theksuar se të njëjtat nuk qëndrojnë, për shkak se pagesat që debitori i ka realizuar nuk janë objekt përmbauesor në këtë çështje përmbauesore. Në fund ka shtuar se debitori me qëllim të evitimit të këtij detyrimi ka shkëputur komunikimin dhe të gjitha kontaktet me kreditorin, si dhe nuk i është përgjigjur thirrjeve telefonike. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi i debitorit, ndërsa urdhri për përmbauesor të mbetet në fuqi.

Gjykata Themelore në Prishtinë - Dega në Gllogoc, lidhur me këtë çështje përmbauesore me Aktvendimin PPP.nr.9/2018 të datës 13.11.2018, e ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit, ndërsa ka shfuqizuar urdhrin përmbauesor P.nr.649/17 të datës 28.12.2017, të Përmbauesit Privat Gjokë Radi.

Gjykata e Apelit e Kosovës, me Aktvendimin Ac.nr.839/2019 të datës 11.02.2020, ka aprovuar si të themeltë ankesën e të autorizuarit të kreditorit dhe ka anuluar aktvendimin

PPP.nr.9/2018 të datës 13.11.2018, të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Gllogoc dhe e ka kthyer lëndën në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe vërejtjeve të dhëna sipas aktvendimit të Gjykatës së Apelit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbartimore gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbartim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara dhe janë të përshtatshme për përmbartim, bazuar në dispozitat e nenit 29 par.3 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*. Me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbartuesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm - Faturën Nr. 06/2017 të datës 06.09.2017; Faturën Nr. 09/2017 të datës 10.11.2017; Faturën Nr. 10/2017 të datës 13.11.2017 dhe Faturën Nr. 13/2017 të datës 14.12.2017, i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara mallrat të cilat kanë qenë objekt i këtyre faturave është përcaktuar shuma e cila përben detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat e lartcekura i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP, për zbatimin e përmbartimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që të njëjtat janë dorëzuar në origjinal dhe mbajnë nënshkrimin e pranimit të debitorit.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera të debitorit, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi i procedurës përmbartimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të formalitetit rigoroz, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbartimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit si objekt përmbartimi.

Andaj bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbartimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

#### GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.2604/22, datë 06.06.2024

Gjyqtari

Hasan Kryeziu

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.